



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 11 janar 2022

Znj. Donika Gërvalla, Ministre
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
Rr. “Luan Haradinaj”
10000 Prishtinë

Letër rekomandimi

Ankesa nr.114/2021

Edina Elezi
kundër

Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

E nderuara znj. Gërvalla,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 18 shkurt 2021 e ka pranuar ankesën e znj. Edina Elezi, nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar, parashtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) për mospranim dhe mosregjistrim të kërkesës për njoftim.

Sipas pohimeve të ankueses dhe dokumentacionit të paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), më 18 dhjetor 2020 znj. Elezi i është nënshtruar intervistimit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës, në bazë të konkursit i shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme më 27 tetor 2020, në të cilin ajo ka aplikuar. Znj. Elezi pretendonte se ajo nuk është njoftuar zyrtarisht nga MPJD-ja për mospërzgjedhjen e saj në pozitën e lartcekur, andaj e njëjta më 7 janar 2021 i është drejtuar Konsullatës së Republikës së Kosovës në Cyrih me kërkesë për informata, por nuk ka marrë përgjigje. Më 21 janar 2021 znj. Elezi, nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar nga Shoqëria e avokatëve “Sejdiu-Qerkini”, i është drejtuar MPJD-së me kërkesë për njoftim në lidhje me përzgjedhjen e kandidatit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës, por kërkesa e ankueses nuk është pranuar dhe po ashtu nuk është regjistruar nga MPJD-ja. Duke qenë se kërkesa për njoftim nuk është pranuar, ankuesja kërkesën e ka dërguar edhe nëpërmjet postës, por e njëjta gjithashtu nuk është pranuar nga MPJD-ja dhe i është kthyer mbrapa.

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

Më 11 mars 2021, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet postës elektronike, iu ka drejtuar me shkresë sekretarit të përgjithshëm të MPJD-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata për arsyen e mospranimit të kërkesës dhe për veprimet të cilat MPJD-ja i ka ndërmarrë apo planifikonte t'i ndërmerre përkitazi me çështjen e ankueses.

Më 20 prill 2021, përfaqësuesja e IAP-së ka marrë përgjigje nga sekretari i përgjithshëm i MPJD-së, nëpërmjet së cilës është njoftuar si në vijim: *“Duke ju referuar kërkesës suaj, më lejoni t’ju njoftoj se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk është kompetent për sa i përket ankesave të stafit lokal-vendor. Bazuar në rregulloren me Nr.04/4014 për plotësimi dhe ndryshimin e rregullores 02/2009, për Shërbimin e Jashtëm, Nenit 4 pika 1.1 Shefi i misionit është përgjegjës dhe Autoriteti i fundit në hierarkinë e Shërbimit të Jashtëm, sa i përket kërkesave, ankesave lidhur me Personelin Vendor në Misione. Për realizimin e të drejtave të tyre Personeli Vendor i nënshtrohet legjislacionit të Shtetit pranues. Për sa i përket procedurës së ankimit ju lutem konsultohuni me legjislacionin e shtetit në të cilin ka aplikua znj. Eldin Elezi në çoftëse parashihet një gjë e tillë.”*

Më 20 prill 2021, përfaqësuesi i autorizuar i ankueses, nëpërmjet postës elektronike është njoftuar për përgjigjen e MPJD-së.

Qëllimi

Objekti i çështjes së letrës me rekomandim është tërheqja e vëmendjes së MPJD-së, përkitazi me mospranimin dhe mosregjistrimin e kërkesës për njoftim e znj. Elezi, nga kjo ministri, në lidhje me përzgjedhjen e kandidatit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës.

Po ashtu letra me rekomandim ka për qëllim vlerësimin nëse veprimi i MPJD-së është në pajtim me parimin e ligjshmërisë, me parimin e informimit dhe të ndihmës aktive. Letra me rekomandim do të japë rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që MPJD-ja duhet t’i ndërmarrë për respektimi e plotë të ligjeve në fuqi dhe të të drejtave të njeriut.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Ndërsa në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”* Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit”* (neni 16, paragrafi 1);
- *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
- *“t’u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);

- *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).

Baza ligjore

Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) përcakton si në vijim: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*

Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 73, paragrafi 1, përcakton: *“Përveçse kur ligji parashikon një formë të caktuar, kërkesa e palës për fillimin e procedurës administrative mund të bëhet:1.1. në formë të shkruar, 1.2. me gojë përpara organit publik dhe të regjistrohet në procesverbal nga organi publik, ose1.3. në çdo formë tjetër të përshtatshme dhe të mundshme.”*

Paragrafi 1 i nenit 74 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: *“Një kërkesë mund të parashtrohet drejtpërdrejt në organin publik të cilit i drejtohen, po ashtu edhe në organet e tij lokale, nëse ka të tilla.”* Ndërsa paragrafi 5 përcakton: *“Një kërkesë me shkrim, gjithashtu mund të parashtrohet me postë apo në mënyrë elektronike drejtpërdrejt në adresën zyrtare të organit të cilit i drejtohet.[...].”*

Paragrafi 1 i nenit 75 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative shprehimisht përcakton: *“Kur një organ publik merr një kërkesë me shkrim që është jashtë kompetencave të veta, pa vonesë do t’ia kalojë kërkesën organit kompetent dhe do të njoftojë dërguesin për këtë.”*

Paragrafi 1 i nenit 76 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: *“Parashtrimi i kërkesës do të regjistrohet nga organi ku ajo është parashtruar, sipas radhës së parashtrimit. Kërkesat që dorëzohen me të njëjtën dërgesë postare do të vlerësohen si të parashtruara njëkohësisht.”* Ndërsa paragrafi 2 përcakton: *“Parashtruesit i lëshohet një vërtetim që dëshmon pranimin, datën, qëllimin e kërkesës si dhe listën e dokumenteve të bashkëngjitura, nëse ka të tilla.”*

Konstatimet

Avokati i Popullit, në pajtim me të gjeturat më lart, konsideron se refuzimi i pranimit, mosregjistrimit dhe mospërgjigjja e MPJD-së në kërkesën për njoftim e znj. Elezi, të cilën znj. Elezi më 21 janar 2021 e ka dërguar në MPJD, përkitazi me përzgjedhjen e kandidatit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës, është tregues i qartë i shkeljes së të drejtave të njeriut për faktin se është në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe gjithashtu në kundërshtim me parimet bazë të shtetit demokratik, siç është parimi i ligjshmërisë dhe parimi i informimit dhe i ndihmës aktive.

Avokati i Popullit konstaton se në rastin e znj. Elezi, MPJD-ja ka dështuar t’i përmbushte obligimet ligjore që burojnë nga Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 75, paragrafi 1 dhe neni 76, paragrafët 1 dhe 2.

Për më tepër, Avokati i Popullit rikujton se qëllimi i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, është edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative, transparente, të harmonizuar dhe me fokus te qytetarët.

Bazuar në atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3¹, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit², i


REKOMANDON

Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës:

- ***T'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme përkitazi me kërkesën e ankueses dhe t'i përgjigjet asaj, në pajtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Habit Hajredini, Drejtor

Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

¹ Nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”

² Neni 18, paragrafi 1.2, i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).”